

TIRANE  
SHQIPERIA

QENDRA SHQIPTARE PËR KËRKIME EKONOMIKE


**RAPORT PERMBLEDHES**

**RAPORT PERMBLEDHES**

**RAPORT PERMBLEDHES**

**RAPORT PERMBLEDHES**

**RAPORT PERMBLEDHES**



**Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike**

**1997**



# QENDRA SHQIPTARE PER KERKIME EKONOMIKE Q.SH.K.E.

Rruga "A. Frasheri", Pall. 4, Hyrja 3, Apt. 24

Kutia Postare Nr. 2934, Tirane, SHQIPERI

Tel/Fax: 042/ 25 021

E-mail: zefi@qske.tirana.al

Nr. i Llog. Bankare 1540/3684

(Banka e Kursimeve, Dega Tirane)

---

## *Nje historik i shkurter*

Qendra Shqiptare per Kerkime Ekonomike (Q.Sh.K.E.) eshte nje organizate e pavaruar jo-qeveritare qe nuk ndjek qellime fitimi e themeluar nga nje grup ekonomistesh, bankieresh dhe profesoresh shqiptare ne Nentor te vitit 1992. Ajo eshte regjistruar ne Gjykatën e Rrethit te Tiranës ne Qershor 1993.

Granti i pare nga jashte eshte dhuruar nga Qendra Nderkombetare per Rritjen Ekonomike (ICEG-San Francisko), ne Dhjetor 1992 dhe eshte ndjekur nga disa te tjere gjate viteve te mevonshme.

Q.Sh.K.E. ka filluar botimin e revistes "*Ekonomia dhe Tranzicioni*" ne Qershor 1994.

## *Misioni*

Q.Sh.K.E. ka per mision kryesor te saj:

- te nxise zhvillimin e politikave ekonomike te tregut te lire;
- te ndertoje nje kuptim me te mire nga ana e publikut te ceshtjeve te zhvillimit ekonomik, dhe
- te zhvilloje nje institucion kerkimor nderdisiplinar te njohur per te dhena, analiza, vrojtime, kerkime dhe opinione ekspertesh ne fushen e ekonomise.

## *Strategjia*

Per te arritur qellimet e veta, Q.Sh.K.E. ndermerr *veprimtarite* qe vijojne:

- kerkime dhe menaxhim te kerkimeve;
- organizim te ngjarjeve publike;
- vrojtime;



- pergatitje te raporteve te vrojtimit, interpretimin e te dhenave te grumbulluara, prezantime ne shtyp dhe median audio-vizuale;
- keshillime mbi ceshtjet kryesore te politikave ekonomike;
- konsulence parlamentare.

*Audienca e veprimtarive te Qendres perbehet nga:*

- politikanet e qeverise qendrore dhe lokale
- qeveria qendrore
- pushteti lokal
- komuniteti kerkimor
- komuniteti i biznesit
- ekonomistet dhe financieret
- studiuesit
- gazetaret
- studentet

### *Organizimi*

Si nje organizate jo-qeveritare, Q.Sh.K.E. drejtohet nga nje Bord Besimi i perbere nga 6 eksperte te njohur te fushes se ekonomise, financave, bankave, menaxhimit te biznesit, etj. *Drejtimi operativ* i Qendres kryhet nga Drejtori i saj, i emeruar nga Bordi.

Ne periudhen 1993-1996, Q.Sh.K.E. punesoi 4 punonjes efektive me kohe te plote dhe 7 punonjes me kohe te pjesshme; gjithsej 11 vete.

Nje numer *bashkepuntoresh te jashtem* kane ndihmuar Qendren Shqiptare per Kerkime Ekonomike ne realizimin e nje numri detyrash te saj. Mesatarisht, gjate vitit, numri i bashkepuntoreve ka kaluar 10 vete.

### *Vezhgimet*

Me qellim qe te mbledhe informacion rreth zhvillimeve te situates ekonomike te vendit, Q.Sh.K.E. organizon here pas here *vrojtme* ne zona te ndryshme ose ne te gjithe territorin e vendit. Vrojtmet jane orientuar nga nevojat e projekteve kerkimore qe jane ndermarre, dhe rezultatet jane publikuar nepermjet veprimtarive te tilla si tavolina te rrumbullakta debati, botimeve ne shtypin vendas dhe te huaj, ne revisten tremujore te Qendres, ne median audio-vizuale, etj.

Ne vitin 1995, Qendra organizoi vrojtimin e pare qe iu kushtua problemeve te biznesit te vogel. Ai u mbeshtet ne nje pyetesor te pergatitur ne bashkepunim me Prof. T. Mroczkowski nga Universiteti Amerikan i Washingtonit, qe ishte edhe konsulent i projektit. Nepermjet ketij vrojtimi u mblodhen te dhena ne zonat kryesore te vendit, dhe u sigurua nje baze e rendesishme informacioni mbi zhvillimin dhe problemet kryesore te sektorit te biznesit te vogel ne Shqiperi.

Raporti perfundimtar i ketij vrojtimi dhe rekomandimet kryesore politike te tij u bene baza e nje tavoline te rrumbullaket debati, qe u mbajt ne Janar 1996 ne Tirane, si dhe te disa botimeve te mevonshme brenda dhe jashte vendit.

### *Konsulenca Parlamentare*

Konsulenca parlamentare eshte nje nga tiparet e reja te veprimtarise se Qendres Shqiptare per Kerkime Ekonomike. Ajo perfshin grumbullimin e materialeve te ndryshme kerkimore, sigurimin e akteve ligjore te ndryshme, pergatitjen e draft ligjeve dhe diskrimin e tyre ne rrethe specialistesh, etj. Te diktuara nga veprimtaria kerkimore e derisotme, fushat kryesore te konsulences parlamentare jane problemet e sistemit bankar, te tregut te kapitaleve, sistemit te sigurimeve shoqerore, etj.

Ne kete kuader duhet permendur organizimi nga Q.Sh.K.E. i Tryezes se Rrumbullaket mbi "Mbrojtjen e Depozitave ne Shqiperi", me 28 Shkurt 1997. Objekti i kesaj Tryeze ishte prezantimi dhe diskutimi i projekt-ligjit "Mbi Mbrojtjen e Depozitave", pergatitur nga Qendra Shqiptare per Kerkime Ekonomike. Si rezultat i punimeve te kesaj veprimtarie dhe bashkepunimit te Qendres me Banken e Shqiperise, eshte realizuar pergatitja e draftit perkates te ligjit.

### *Rreth vitit te punes 1996*

Ne vitin 1996, Q.Sh.K.E. e perqendroi veprimtarine e saj ne problemet e *Barrierave te Fshehta ndaj Rritjes Ekonomike ne Vendet e Ballkanit*. Ne vitin e pare te ketij projekti, ne bashkepunim me Institutin per Ekonomine e Tregut (Bullgari) dhe Qendren per Kerkime Politike dhe Analiza Krahasuese (Rumani), Q.Sh.K.E. vrojtoi, analizoi, dhe studioi disa nga problemet kryesore ekonomike, qe u konsideruan nga ekipet kerkimore te te tre instituteve si aspekte te barrierave ndaj rritjes ekonomike. Mbi kete baze u organizuan kater takime rajonale te eksperteve ekonomiste, duke perfshire dy konferenca. Fushat kryesore kerkimore qe u percaktuan ne marreveshjen perkatese ndermjet tre grupeve te punes kishin te benin me realitetin e periudhes se pas-embargos se Kombeve te Bashkuara ndaj ish-Jugosllavise dhe rritjen ekonomike; subvencionet e fshehta; tregjet financiare paralele dhe te fragmentuara, etj.

Konferenca e pare u mbajt gjate diteve te Mbledhjes Vjetore te Bankes Europiane per Rindertim dhe Zhvillim me 14 Prill 1996, ne Sofie (Bullgari) dhe tjetra ne fund te fazes se pare te projektit Rrjeti Ballkanik me 11 Tetor 1996, ne Bukuresht (Rumani).

Ne keto veprimtari u publikuan rezultatet kryesore te kerkimeve qe kishin te benin me ekonomine informale, tregun informal te kreditit dhe subvencionet e fshehta. Keto rezultate u bene te njohura gjithashtu edhe nepermjet revistes se Qendres dhe artikujve te ndryshem te botuar ne shtypin e perditshem vendas.

Gjithashtu, punonjesit dhe bashkepunoret e jashtem te saj vendosen nje bashkepunim te qendrueshem me kunderpartet e tyre bullgare dhe rumune,

ne te cilen perfshihet shkembimi i rregullt dhe i shpeshte i informacionit dhe opinioneve.

### *Projektet Kerkimore*

#### **- 1993-1994**

*Botimet Shqiptare mbi Problemet e Ekonomise se Tregut*, mbeshtetur nga ICEG. Ne kuadrin e ketij projekti jane perkthyer dhe botuar ne gjuhen shqipe 13 permbledhje librash mbi problemet e ekonomive te vendeve me pak te zhvilluara dhe te atyre ne tranzicion. Botimet me tirazh 1.000 kopje u shperndane falas ndermjet politikaneve, qeveritareve, rretheve te biznesit, pedagoqeve te fakulteteve ekonomike te vendit, studenteve, shtypit dhe medias, etj.

#### **- 1994**

*Vrojtim mbi Aftesite Menaxhuese te Sipermarresve te Rinj*, mbeshtetur nga ICEG. Nepermjet ketij vrojtimi u mblodh informacioni i nevojshem per problemet me kryesore te sipermarresve te rinj te Shqiperise ne periudhen pas-socialiste. Rezultatet u shfrytezuan per disa veprimtari publike dhe botuese te mevonshme.

#### **- 1994-1995**

*Vrojtim per Problemet e Zhvillimit te Sektorit te SME-ve*, mbeshtetur nga Qendra Nderkombetare per Sipermarrjen Private (CIPE). Vrojtimi mbuloi me perfaqesim gjithe territorin e vendit dhe sherbeu si baze per formulimin e rekomandimeve politike perkatese. Keto rekomandime u bene te njohura nepermjet nje Tavoline te Rrumbullaket debati ne Janar 1996. Ato u perqendruan ne ceshtjet financiare te bizneseve te vogla, perfshire ndikimin e sektorit informal te kreditit (parave me fajde), problemet e prodhimit dhe te marketingut, problemet e aftesive te personelit, problemet e krijimit te nje mjedisi mbeshtetes per bizneset e vogla, si dhe disa probleme qe meritonin vemendje ne te ardhmen. Punimeve te tavolines se rrumbullaket te debatit te mbajtur me daten 11 Janar 1996 iu kushtua nje numer i posaqem i revistes "*Ekonomia dhe Tranzicioni*". Nepermjet shtypit, publiku u informua gjeresisht rreth rezultateve te arritura ne kete projekt.

#### **- 1996-1997**

Projekti "*Rrjeti Ballkanik*". Ky projekt mbeshtetet nga Agjencia Amerikane per Zhvillim Boteror (USAID), nepermjet nje granti dhene shoqates amerikane me qender ne Washington, "*Chesapeake Associations*". Ky projekt kerkimor ka dy linja kryesore, njera problemore dhe tjetra organizative. Nga pikepamja organizative nepermjet projektit u synua:

*Se pari*, vendosja e nje lidhjeje te qendrueshme ndermjet tre instituteve te politikave publike pjesemarrrese nga Shqiperia, Bullgaria dhe Rumania. Keto lidhje perfshijne shkembimin e perves, te dhenave dhe funksionimin si nje rrjet unik komunikimi. Ne kete shkembim perfshihet edhe permiresimi i

politikave te menaxhimit, procedurave te mbajtjes se llogarive, aftesive kerkimore dhe aspekteve te tjera te komunikimit qe çojne ne permbushjen e qellimeve te krijimit te Q.Sh.K.E.

*Se dyti*, qellimi i ketij projekti ishte forcimi i Q.Sh.K.E. deri ne aftesimin e saj per te bere pune te pavarur ne formulimin e politikave publike.

Perberesi i dyte i ketij projekti ka te beje me studimin e barrierave te fshehta ndaj rritjes ekonomike ne vendet perkatese, ne rrugen e tyre drejt ekonomise se tregut. Barriera te tilla u konsideruan ekonomia informale qe vjen nga korrupsioni dhe privatizimi ilegal, embargoja ekonomike, tregtia dhe barrierat doganore, regjimi joefektiv i taksave dhe barrierat e ndryshme qe lidhen me venien ne jete te kuadrit ligjor te pergatitur.

Mbeshtetur ne pervojen e vitit te pare te ketij projekti, bashkepunimi midis tre vendeve themeluese eshte zgjeruar me pjesemarrjen e 17 organizatave nga 11 vende te Europes Qendrore dhe Lindore. Ky rrjet quhet 3ENet dhe bashkepunimi ndermjet pjesemarrsesve te tij shprehet te vazhdoje edhe pas perfundimit te ketij projekti.

#### 1997

Projekti "*Rrjeti i Lidhjeve te Europes Jugore*", eshte mbeshtetur nga CIPE dhe Programi Phare i bashkepunimit. Q. SH. K. E. bashkepunon ne kete projekt si nen-kontraktore e Fondit te Kerkimeve te Aplikuara dhe Komunikimeve (ARC Fund) te Sofies, Bullgari. Qellimi i projektit eshte grumbullimi i informacionit, analiza e tij dhe shkembimi i pervojes me kunderpartet bullgare te Qendres per Studimet e Demokracise (CSD) te Sofies, Bullgari per problemet e zhvillimit ekonomik rajonal.

#### Ngjarjet Publike

Nje numer veprimtarish publike jane organizuar nga Qendra, dhe ne disa te tjera ajo ka marre pjese me kumtesa, referate, diskutime, si veshguese, etj. Ne pergjithesi, audienca e ketyre veprimtarive ka qene e zgjedhur ne perputhje me qellimin e mbledhjes.

Veprimtarite e organizuara nga vete Qendra kane mbuluar fusha te tilla si biznesi i vogel, tregu informal i kreditit dhe ekonomia informale, mbrojtja e depozitave te qytetareve, etj. Ne keto veprimtari, pothuajse ne te gjitha rastet kane marre pjese edhe eksperte te huaj qe punojne ne Shqiperi, perfaqesues te organizatave qe kane mbeshtetur Qendren, punonjes te trupit te huaj diplomatik qe punojne ne vend, etj.

Ndersa veprimtarite ne te cilat Qendra eshte perfaqesuar kane qene te lidhura me probleme te ndryshme te tranzicionit te ekonomise drejt nje ekonomie te tregut te lire. Ne pergjithesi, keto veprimtari kane sherbyer per te permiresuar pergatitjen e punonjesve kerkimore te Qendres, per grumbullimin e pervojes se nevojshme per te organizuar veprimtari te ngjashme ne vend dhe, mbi te gjitha, per te vendosur kontakte dhe bashkepunim me institucione te ngjashme ose me donatore te ndryshem europiano-perendimore dhe nga SHBA.

### *"Data base" e te dhenave*

Q.Sh.K.E., me infrastrukturen modeste qe zoteron, ka grumbulluar dhe sistemuar nje vellim te dhenash te ndryshme, kryesisht rezultatet e vrojtimeve te kryera prej ose nen drejtimin e saj, ne realizimin e te cilave eshte shfrytezuar edhe biblioteka e saj modeste. Fondi i kesaj biblioteke perbehet kryesisht nga dhurimet e ICEG.

### *Kontaktet e Brendshme*

Per te permbushur misionin e vet, Q.Sh.K.E. ka vendosur nje numer kontaktesh brenda vendit. Keto kontakte perfshijne diskutimet personale dhe shkembimin e mendimeve, intervistat, ftesat per te marre pjese ne ngjarje publike, bashkepunimin ne veprimtarite kerkimore dhe ne veprimtari te tjera, pjesemarrjen ne konferenca te organizuara nga institucione te njohura si Universitetet e Shqiperise, Programi Rrjeti i Demokracise, Projektet SMEDA, CEELI, etj. Keto kontakte kane kontribuar ne zhvillimin dhe ne forcimin e lidhjeve te Q.Sh.K.E me komunitetin e biznesit dhe institucionet e tjera qeveritare dhe jo-qeveritare te vendit. Lidhje te vecanta ka krijuar kjo qender me gazetaret dhe institucionet e ndryshme te shtypit duke u perpjekur te ndikojne per nje kuptim me te gjere nga ana e tyre mbi tranzicionin dhe disa nga problemet kryesore te tij.

Qendra eshte anetare e Forumit te Organizatave Jo-qeveritare te vendit qe prej vitit 1993 dhe bashkepunon rregullisht me kete organizate. Q.Sh.K.E shkemben informacion dhe bashkepunon edhe me nje numer organizatash jo-qeveritare vendase qe veprojne ne fusha te ngjashme interesi.

Nepermjet ketyre lidhjeve, dhe vecanerisht nepermjet kontakteve me median audio-vizuale dhe me shtypin, Qendra ka bere kujdes per te afishuar hap pas hapi natyren e pavarur te veprimtarise qe ajo kryen, duke nxitur zgjerimin e debatit dhe te shkembimit te mendimeve alternative per probleme te ndryshme te tranzicionit te ekonomise se vendit.

Q.Sh.K.E. eshte udhehequr pergjithesisht nga vlerat e pamohueshme te mendimit liberal klasik dhe lufton per te plotesuar njohurite rreth kesaj fushe jo vetem me stafin e saj, por ne te gjitha kontaktet qe burojne nga ushtrimi i veprimtarise kerkimore dhe botuese.

Q.Sh.K.E. ka vendosur lidhje te mira me perfaqesuesit e organizatave te huaja qe veprojne ne Shqiperi dhe me projektet e ndryshme rajonale. Nepermjet ketyre kontakteve, ajo synon te zgjidhe problemet e mbijeteses financiare si institucion, por edhe te permiresoje aftesite profesionale te stafit te vet, etj. Kontaktet me zyren lokale te USAID kane luajtur nje rol te vecante ne permbushjen e misionit te saj.

### *Lidhjet me jashte*

Nepermjet kanaleve te ndryshme te komunikimit, Q.Sh.K.E., ka vendosur nje

sere lidhjesh te qendrueshme me qarqet akademike perendimore dhe me nje numer institutesh te politikave publike ne Amerike, Britanine e Madhe, Gjermani, Turqi, Greqi, Itali, France, Austri, Holande, etj. Per lidhjet e saj me jashte, te nje rendesie te vecante jane Rrjeti i Instituteve Korrespondente te ICEG, rrjeti i CIPE, bashkepunimi me rrjetet e postes elektronike te Hayek-ut, Line (Holande), etj. Keto lidhje, ne shumicen e rasteve, jane realizuar nepermjet postes elektronike te realizuar falas nga ana e zyres se PNUD-it ne Tirane qe eshte edhe projekti i vetem ne kete fushe per OJQ-te ne Shqiperi.

Ne zbatimin e strategjise se saj kerkimore, Qendra eshte duke bere perpjekje per zgjerimin e bashkepunimit edhe me nje numer institucionesh te tjera qe veprojne ne rajonin Ballkanik dhe ne vendet e Europes Qendrore dhe Lindore, si me Fondacionin Forumi Kombetar, Zyren rajonale te CIPE ne Budapest, Fondacionin "F. Nauman" (Gjermani), ELIAMEP (Greqi), etj.

Gjate pese viteve qe kane kaluar, Q.Sh.K.E. eshte ftuar te marre pjese ne takimet vjetore dhe konferencat rajonale te CIPE, ne kurset e trainingut te ICEG dhe CIPE, etj. Te nje rendesie te vecante per kete qender ishin pjesemarrja ne Takimin vjetor te Shoqates Mont Pelerin dhe ne Seminarin Nderkombetar e 28-te, te Fondacionit te Kerkimeve Ekonomike Atlas (Shtator 1996). Ajo ka qene e ftuar edhe ne disa veprimtari te tjera te rendesishme te ketyre organizatave ne gjysmen e pare te vitit 1997, por per shkak te situates se jashtezakonshme ne vend, nuk mori pjese ne to.

Qendra ka perfituar shume edhe nga vizitat prane saj te profesoreve dhe eksperteve te njohur te fushes se ekonomise si te Dr. George A. TRUITT (Drejtor i ICEG per Europen Qendrore dhe Lindore, SHBA, 1993), Steve H. HANKE (Universiteti Johns Hopkins, Baltimore, SHBA, 1994), Ilka SCHOELLMAN (Konsulent e Rajonale e CIPE, Washington D.C., 1994, 1996), Prof. Lee BENHAM (Universiteti Amerikan i Washingtonit, 1994), Ronald PHILIPS (President i Coast Enterprise, Maine, SHBA, 1994), Margot MACHOL (Presidente e Chesapeake Associations, Washington D.C., 1995, 1996), Prof. Allan MELTZER (Pittsburgh University, Pensilvani, SHBA, 1996), Dr. Julian BHARIER (Konsulent, BESO, Sherbimet Ekzekutive Britanike per te Huajt, Britani e Madhe, 1996), Dr. Francesco ALIPRANDI (Misioni Katolik-FAO, Milano, Itali, 1996), Allan HAWKINS (Agjensia e Rehabilitimit Bankar, USAID, Shkup, Maqedoni, 1997), Antonio RANDAZZO (Korpusi i Vullnetareve te Sherbimeve Financiare, 1997).

Gjate vitit 1997, Qendra ka perfituar nga asistenca teknike ne punen kerkimore te saj nga FDIC (Korporata Federale e Mbrojtjes se Depozitave, SHBA), dhe FSVC (Korpusi i Vullnetareve te Sherbimeve Financiare).

Gjithashtu, Dr. Z. Preçi, Drejtor i Qendres eshte inisiatori i vendosjes se bashkepunimit per krijimin e rrjetit te pare televiziv ne Europen Qendrore dhe Lindore. Pervec kontributit te tij ne ngritjen e struktures lokale te ALFA TV, ai eshte anetar i Bordit Nderkombetar te Besimit te ALFA TV qe nga krijimi i tij (Qershor 1994).

## Financat

Burimet kryesore te financimit te Qendres jane grantet e bazuara ne aplikimet e bera. Siç u shpegua edhe me lart, keto fonde kane ardhur kryesisht nga burime jo-qeveritare te organizatave nderkombetare, ndersa projekti aktual (*Rrjeti Ballkanik*) eshte mbeshtetur nga Agjensia Amerikane per Zhvillim Boteror (USAID).

Pervec ketyre, te ardhurat "in kind" (jo ne para) te saj perbehen nga ndihmesa e agjensive shteterore dhe lokale, e organizatave qeveritare shqiptare, etj. te shprehura kryesisht ne kumtesat, referatet, revistat, studimet e plota, librat, buletinet informative, etj., te botuara dhe te pabotuara. Nje sasi minimale te ardhurash eshte siguruar nga shitja ne treg e revistes "Ekonomia dhe Tranzicioni", te cilat jane perdorur per te vazhduar botimin e saj te metejshe.

Diversiteti i burimeve financiare, megjithe mungesen e mbeshtetjes se brendshme financiare per shkaqe lehtesisht te kuptueshme, ka ndihmuar ne ruajtjen e pavaresise se kesaj qendre.

## Publikimet

Qysh nga krijimi i saj, Q.Sh.K.E. ka pergatitur rreth 40 dokumente, nje pjese e te cilave mund te sigurohet falas nga arkivi i saj. Ajo po ben perpjekje per grumbullimin dhe sisteminin e tyre ne kompjuter me qellim qe te jene lehtesisht te perdorshme nga personat e interesuar. Vec sa me siper, bashkepunetoret e Q.Sh.K.E kane publikuar me shume se 50 artikuj problemore ne shtypin vendas dhe te huaj. Ne vijim jepet lista e nje pjese te punimeve te pergatitura gjate kesaj kohe nga Qendra:

1994

- Preçi Z., *Dekolektivizimi dhe Tranzicioni Bujqesor ne Shqiperi*, Projekt Kerkimor, sponsorizuar nga RSS e CEU, Prage, ne Tirane, me 1993-1994.
- Preçi Z., *Dekolektivizimi dhe Tranzicioni Bujqesor ne Shqiperi*, Material i botuar ne shqip, Nr. 1, Raport per RRT, sponsorizuar nga ICEG - San Francisko, Tirane, Tetor 1994.
- Preçi Z., *Dekolektivizimi dhe Tranzicioni Bujqesor ne Shqiperi*. Kumtese e prezantuar ne Konferencen e 3-te te European Association for Economic Comparative Studies (EACES), me 8-10 Shtator 1994, ne Budapest, Hungari.
- Ilmia S., *Politika Fiskale ne Shqiperi*. Kumtese e botuar nga Q.Sh.K.E ne kuadrin e Tavolines se Rrumbullaket, sponsorizuar nga ICEG,

Dhjetor 1994.

### 1995

- Hysa B., *Politika e Pagave ne Shqiperi*, revista "Ekonomia dhe Tranzicioni", Nr. 3 (5), 1995.

- Preçi Z., *Politikat Bujqesore Afatgjata per Europen Qendrore dhe Lindore: Rasti i Shqiperise*, kumtese e prezantuar ne Konferencen Nderkombetare te ICEG, 17-20 Maj 1995, Prage, Republika Çeke.

- Preçi Z., & others..., *Zhvillimi i Biznesit te Vogel ne Shqiperi*, Projekti Kerkimor i Q.Sh.K.E Drejtor projekti, sponsorizuar nga CIPE, Washington DC., Tirane 1995.

- Preçi Z., Salko, D., *Tregjet Financiare ne Shqiperi: Bursa*, revista "Ekonomia dhe Tranzicioni", Q.Sh.K.E, Tirane, Nr. 4 (8), 1995.

- Preçi Z. *Dekolektivizimi dhe Tranzicioni Bujqesor ne Shqiperi: Perspektiva e Zhvillimit*, Kumtese e paraqitur ne tubimin shkencor: "Rezultate dhe Probleme te Tranzicionit Ekonomik ne Maqedoni dhe Shqiperi", mbajtur ne Oher (Maqedoni), 29-30 Shtator 1995).

### 1996

- Bejko, M., *Mbi Çmimin dhe Politiken e Subvencionimeve ne Shqiperi*. Kumtese e paraqitur ne konferencen "Mbi Barrierat e Fshehta ndaj Rritjes Ekonomike ne Vendet e Ballkanit", e mbajtur me 15 Prill 1996, Sofie, Bullgari.

- Bejko M., *Mbi Reformen ne Sektorin Energjistik*, revista "Ekonomia dhe Tranzicioni", Nr. 1 (7), 1996.

- Gerxhani K., *Zhvillimi i SME-ve - Subjekt Partneriteti midis Qeverise dhe NGO-ve (pervoja e Q.Sh.KE)*. Rast studimor i prezantuar ne Konferencen mbi "Bashkepunimin midis Qeverise Shqiptare dhe NGO-ve per Zhvillimin Ekonomik ne Shqiperi", organizuar nga ORT (Rrjeti i Demokracise), me 5-7 Dhjetor 1996, Korçe, Shqiperi.

- Harshorva A., *Te ardhurat ne Bujqesi dhe Palevizshmeria Relative e Burimeve Bujqesore*, revista "Ekonomia dhe Tranzicioni", Nr. 2 (8), 1996.

- Hashorva A., *Disa Perspektiva te Zhvillimit te Sistemit Taksor ne*

*Sektorin Bujqesor Shqiptar*. Kumtесе e prezantuar ne konferencen "Rritja Ekonomike dhe Mundesite e Zhvendosjes se Barrierave te Fshehta", me 11 Tetor 1996, Bukuresht, Rumani.

- Muço M., & Salko D., *Disa Probleme mbi Zhvillimin e Sektorit Financiar Joformal ne Shqiperi*. Kumtесе e paraqitur ne konferencen "Mbi Barrierat e Fshehta ndaj Rritjes Ekonomike ne Vendet e Ballkanit", e mbajtur me 15 Prill 1996, Sofie, Bullgari.

- Muço M., & Salko D., *Disa Probleme mbi Zhvillimin e Sektorit Financiar Joformal ne Shqiperi*. Kumtесе e prezantuar ne konferencen "Rritja Ekonomike dhe Mundesite e Zhvendosjes se Barrierave te Fshehta", me 11 Tetor 1996, Bukuresht, Rumani.

- Preçi Z., *Kultivimi i "Canabis-Sativa" ne Shqiperi - Aspekte te Ekonomise Joformale*. Reviste Sociologjike e Qendres se Pavarur per Kerkime Sociologjike, "EUREKA", Nr. 3, 1996.

- Preçi Z., & Gerxhani, K., *Sektori Joformal ne Shqiperi: Disa Aspekte te Zhvillimit te tij gjate periudhes 1991-1996* (Rast Studimor), revista "Ekonomia dhe Tranzicioni" Nr. 2(8), 1996, Tirane, Shqiperi.

- Preçi Z., & Gerxhani, K., *Mbi disa Probleme te Sektorit Joformal ne Shqiperi*. Artikull i botuar ne revisten "The Balkan Analyst", Nr. 4 (Tetor - Dhjetor) 1996.

- Preçi Z., and others., *Politikat Bujqesore Afatgjata per Europen Qendrore dhe Lindore: Rasti i Shqiperise*, bashkeautor, 125-140 p. botuar nga Prof. Johnson D. Gale, Universiteti i Çikagos, USA, 1996.

- Preçi Z., & Gerxhani, K., *Sektori Joformal ne Shqiperi: Punesimi i Paregjistruar dhe Pasojat Fiskale*. Kumtесе e prezantuar ne konferencen "Rritja Ekonomike dhe Mundesite e Zhvendosjes se Barrierave te Fshehta", me 11 Tetor 1996, Bukuresht, Rumani.

- Preçi Z., *Forçimi i Sektorit te NGO-ve - Nevoje Emergjente per Perparimin e Shqiperise drejt Shoqerise se Lire*. Kumtесе e prezantuar ne Konferencen mbi "Bashkepunimin midis Qeverise dhe NGO-ve Shqiptare per Zhvillimin Ekonomik te Shqiperise Albania", organizuar nga ORT (Rrjeti i Demokracise), me 5-7 Dhjetor 1996, Korçe, Shqiperi.

- Preçi Z., & Gerxhani, K., *Mbi disa Probleme te Sektorit Joformal ne Shqiperi*. Kumtесе e prezantuar ne Konferencen Nderkombetare "Shqiperia drejt Ekonomise se Tregur", me 13-14 Dhjetor 1996, organizuar nga Universiteti i Athines dhe Universiteti i Tiranes, Tirane, Shqiperi.

- Salko D., *Reforma Bankare ne Shqiperi*. Kumtесе e prezantuar ne Konferencen mbi "Bashkepunimin midis Qeverise dhe NGO-ve Shqiptare per Zhvillimin Ekonomik te Shqiperise", organizuar nga ORT (Rrjeti i Demokracise), me 5-7 Dhjetor 1996, Korçe, Shqiperi.

#### 1997

- Gerxhani K., *Sektori Joformal ne Shqiperi: Punesimi i Paregjistruar dhe Pasojat Fiskale*. Kumtесе (e ripunuar ne baze te ndryshimeve te fundit ne Shqiperi) e prezantuar ne Takimin European te Public Choice, me 2-5 Prill 1997, Prage, Republika Çeke.

- Gerxhani K., *Nje Veshtrim mbi Situaten Makroekonomike ne Shqiperi dhe Nevojen Emergjente te Ligjit mbi Sigurimin e Depozitave*. Kumtесе e prezantuar ne Tavolinen e Rrumbullaket "Sigurimi i Depozitave ne Shqiperi", organizuar nga Q.Sh.K.E., me 28 Shkurt 1997, Tirane, Shqiperi.

- Ibrahim F. & Salko D., *Depozitat e Kursimeve ne Tranzicion*. Kumtесе e prezantuar ne Tavolinen e Rrumbullaket "Sigurimi i Depozitave ne Shqiperi", organizuar nga Q.Sh.K.E., me 28 Shkurt 1997, Tirane, Shqiperi.

- Llaci Sh., *Institetet Private te Pensioneve-Kerkese e Zhvillimit te Vendit drejt Ekonomise se Tregut*. Kumtесе e prezantuar ne Tryezen e Rrumbullaket "Mbi Sistemin e Sigurimeve Shoqerore ne Shqiperi", organizuar nga Q. Sh. K. E., ne Maj 1997, Tirane, Shqiperi.

- Pollo B. & Canco G., *Sigurimi Privat i Pensioneve-Kerkese e Kohes; Pervoja e Vendeve te Europes Perendimore*. Kumtесе e prezantuar ne Tavolinen e Rrumbullaket "Mbi Sistemin e Sigurimeve Shoqerore ne Shqiperi", organizuar nga Q. Sh. K. E., ne Maj 1997, Tirane, Shqiperi.

- Preçi Z., *Situata Aktuale dhe Problemet e NGO-ve Shqiptare*. Kumtесе e prezantuar ne Konferencen mbi "Rolin e NGO-ve dhe INGO-ve ne Mbeshtetjen e Demokracise, Shoqerise Civile dhe Bashkepunimit Rajonal", me 25-27 Prill 1997, Stamboll, Turqi.

- Preçi Z., Bashkeautor ne punimin "Economic Freedom Survey, 1997", botim i Institutit Fraser (Kanada), Maj 1997.

- Preçi Z. & Morczkowski T., & Sood J., *Jashte izolimit: Ndertimi i Ekonomise Shqiptare te Tregut te Lire*, Buletini Nderkombetar i Ekonomise se Aplikuar, U.K., Nr.2, 1997.

- Telo I., *Rritja e Raportit Kontribues-Perfitues çon ne Rritjen e Pensioneve*

*Shtetërore*. Kumtëse e prezantuar në Tavolinën e Rrumbullakët "Mbi Sistemin e Sigurimeve Shoqërore në Shqipëri", organizuar nga Q. Sh. K. E., në Maj 1997, Tiranë, Shqipëri.

- Tanku I., *Një Prezantim Analizues i Projekt-ligjit "Mbi Mbrojtjen e Depozitave"*. Kumtëse e prezantuar në Tavolinën e Rrumbullakët "Sigurimi i Depozitave në Shqipëri", organizuar nga Q.Sh.K.E, më 28 Shkurt 1997, Tiranë, Shqipëri.

#### *Botimet periodike*

**"Ekonomia dhe Tranzicioni"** është revista ekonomike tremujore e Qendres Shqiptare për Kërkime Ekonomike. Ajo ka filluar të botohet në gjysmën e parë të vitit 1994.

Artikujt e publikuar deri më sot në revistën e Qendres përfshijnë çështje të ndryshme të tranzicionit si problemet e zhvillimit të biznesit, problemet e kuadrit ligjor dhe institucional të ekonomisë së tregut, problemet e sistemit bankar, të tregut të punës dhe problemet demografike të tranzicionit, etj. Që nga fillimi i saj janë bërë përpjekje për trajtimin e problemeve nga këndvështrime të ndryshme duke respektuar pikepamjet e autoreve. Në të njëjtën kohë, revista është përdorur edhe si tryeze për të bërë publike rezultatet e punës kërkimore të Qendres dhe për të zgjeruar kontaktet e saj brenda dhe jashtë vendit.

**"International Bulletin"** është një botim tremujor në anglisht i Qendres Shqiptare për Kërkime Ekonomike, i cili ka nisur të botohet në fillim të vitit 1997, bazuar në artikujt e revistës *"Ekonomia dhe Tranzicioni"*.

## **QENDRA SHQIPTARE PER KERKIME EKONOMIKE**

**Rruga "A. Frasheri", Pall. 4, Hyrja 3, Apt. 24**

**Kutia Postare Nr. 2934, Tirane, SHQIPERI**

**Tel/Fax: (+355-42) 25 021**

**E-mail: zefi@qske.tirana.al**

### **ÇFARE ESHTË QENDRA SHQIPTARE PER KERKIME EKONOMIKE?**

#### **OBJEKTIVAT**

Qendra Shqiptare per Kerkime Ekonomike eshte nje organizate e pavaruar jo-qeveritare, jo-fitimprurese e themeluar nga ekonomiste, bankiere dhe profesore vendas, per te menaxhuar dhe drejtuar punen kerkimore ne sherbim te:

- nxitjes se zhvillimit te politikave te ekonomise se tregut te lire;
- forcimit te demokracise parlamentare dhe sipermarrjes private ne Shqiperi; dhe
- inkurajimit per nje njohje me te gjere te vlerave klasike liberale ne shoqerine Shqiptare.

#### **ORGANIZIMI**

Qendra perbehet nga nje staf i vogel i qendrueshem / 6 punonjes kerkimore dhe personel administrativ/ dhe nga nje rrjet i gjere analistesh dhe bashkepunetoresh te jashtem.

#### **AKTIVITETET**

Aktivitetet e Qendres perfshijne:

- organizimin e konferencave, seminareve, dhe debateve per nxitjen e nje kuptimi sa me te mire te problemeve te politikave publike;
- ndemarrjen dhe menaxhimin e projekteve kerkimore;
- drejtimin e veprimtarive publikuese;
- ekzistencen si nje qender burimesh te vlefshme informacioni duke krijuar "data bases" dhe duke ofruar sherbime informacioni.